



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.569/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërjetë z.Blerim Dina- Kryetar ,z.Nuhi Paçarizi- Referues, z. Goran Mileković- anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: OE “ Abkons SH.P.K; Hidroing-DKSH.P.K; Swedish Development AB ”- Tiranë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: OE “ Fidan Hasaj B.I ; Ges Plan ”-Prishtinë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Hartimi i Kadastrit të Ujërave (sipas UA SIU) ”, me numër të prok: 210-19-3405-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor / MMPH/ , më datë: 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “ Abkons SH.P.K; Hidroing-DKSH.P.K; Swedish Development AB ” -Tiranë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Hartimi i Kadastrit të Ujërave (sipas UA SIU) ”, me numër të prok: 210-19-3405-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor /MMPH/ .

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Hartimi i Kadastrit të Ujërave (sipas UA SIU) ”, me numër të prok: 210-19-3405-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor / MMPH/.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“ Abkons SH.P.K; Hidroing-DKSH.P.K; Swedish Development AB ”- Tiranë , aprovohet pjesërisht si e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Afati për dorëzimin e ofertës ka qenë deri më: 13.08.2019.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 21.05.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 23.08.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde : 22.08.2019.

Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim bërë me dt: 28.08.2019.

Operatori ekonomik ankues:“ Abkons SH.P.K; Hidroing-DKSH.P.K; Swedish Development AB ”- Tiranë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt.06.09.2019, me nr.569 /19,kundër njoftimit për dhënie të kontratëslidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Hartimi i Kadastrit të Ujërave (sipas UA SIU) ”, me numër të prok: 210-19-3405-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor / MMPH/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:7, 56 , 59 dhe nenin 60të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:17.09.2019, ka autorizuar ekspertinshqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertishqyrtues i prokurimitnë raportin e dt: 26.09.2019sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK-ja, ka shkelur nenin 52 pika 1, 3, OE ankues nuk ka paraqitur ndonjë fakte ne këtë pike vetëm se ka përshkruar nenin blanko te marrë nga ligji. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se ka bere gabim ne vlerën e TVSH-së ku vlerën pa TVSH e ka shënuar 440,914.00 €, kurse te vlera me TVSH ka vendosur shumën 537,700.00 €. Pra, që i bie se OE e ka vendosur vlerën e TVSH-së mbi 21% e jo 18 % sa është norma e TVSH-së sipas Ligjit në Kosovë. Por, sipas interpretimit te KRPP-së nr.46 thuhet se pavarësisht sa është gabimi në normën e TVSH-së, AK mund ta përmirësoj pa njoftuar OE, pasi që nuk llogaritet gabim aritmetik sipas nenit 59.3 te LPP-së. Pra, bazuar në interpretimin e KRPP-së që OE ankues me datë 19.09.2019 i ka bërë një pyetje KRPP-së: Subject: FW: Një pyetje urgjente - Sqarim mbi gabimet ne normën e TVSH ne një oferte ekonomike I/E nderuar përshëndetje, Ne vijim te ankesës qe ABKONS SHPK ka dorëzuar ne 06 Shtator për Tenderin e Kadastrës se Ujit sipas UA, edhe pse afati për plotësimin e ankesës a kaluar, ne po ju përcjellim përgjigjen e KRPPse vetëm qe ta keni si një fakt shtese dhe lehtësues rreth vendosjes për çështjen ne fjale. Do ju luteshim qe këtë e- mail ti a kaloni agjentit prokurues qe i është caktuar ekspertit te prokurimit qe ka marre ne dorëzim lenden tone.

Kurse me datë 20.09.2019 Departamenti i Rregullave të KRPP-së i kthen përgjigje ne lidhje me pyetjen e parashtruar nga OE ankues (citim): Subject: Re: Një pyetje urgjente - Sqarim mbi gabimet ne normën e TVSH ne një oferte ekonomike E nderuar, Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP, ofron interpretimin ligjor si në vijim: Bazuar ne pyetjen tuaj, Autoriteti Kontraktues mund ta korrigjoj normën e TVSH-ës (si psh: nëse OE në vende që ta ofroj normën e TVSH-ës , 8% ose 18% për artikuj gabimisht) . Përgjigjeje e njëjtë KRPP e ka publikuar në E-prokurimi "Informacione" te pyetjet e shpeshta , Përgjigjja me nr.46. Gabimet ne llogaritje te TVSH nuk trajtohen gabime aritmetikore . Departamenti i Rregullave KRPP

Pra ne pyetjet e shpeshta ne faqen e KRPP-së gjendet pyetja e cila trajton rastin ne fjale!

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Pra, bazuar në këtë pretendim të OE ankues, mendojmë se pretendimi është i bazuar pasi që sipas interpretimit si me larte dhe sqarimit te pyetjes nr.46 nuk e trajton gabim aritmetik ashtu siç e ka trajtuar AK-ja. Siç pretendon OE ankues se AK ka bere shkeljen e neneve: 54, 56, 59 dhe 60 te LPP-së e gjithë kjo lidhet me arsyetimin se nëse një OE pa ndonjë arsyetim nga kriteret e dhëna ne njoftim për kontrate dhe ne FDT e eliminon një OE atëherë kjo ndërlidhet me shkeljen e neneve te përshkruara me larte.

Rekomandojmë qe AK te ketë parasysh barazinë ne trajtim te OE-ve duke mos diskriminuar dhe mos shkelur nenin 56 dhe 59 te LPP-së. Pra, shkelja e nenit 7 ka ne varësi nenet e paraqitura si me larte. Pretendimi për këtë është i bazuar pasi qe lidhet me përgjigjen e pretendimit nr.2

Mendimi i ekspertit shqyrtues:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.2), të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 28.09.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se ka pranuar emailin dhe kërkon qe lënda të vendoset nga paneli .

Operatori Ekonomik , me datë 30.09.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës:07.10.2019, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së,si dhe eksperti shqyrtues,u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi

për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtrirat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së ankues znj. Morina deklaroj: Siç kemi theksuar edhe në ankesën tonë qëndrojmë prapa pretendimeve tona se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore gjatë vlerësimit të ofertës tonë dhe padrejtësisht na ka eliminuar , arsyetimi se ne jemi të pa përgjegjshëm pasi që sipas tyre kemi bërë gabim në normën e TVSH-se të cilin gabim AK e cilëson si gabim aritmetikor është i pa bazuar interpretimin e KRPP-së nr 46, pra një mendim të KRPP-së e keni të bashkangjitur në ankesën tonë, kur ti referohemi mendimit të KRPP-së del që gabimi në normën e TVSH-se nuk konsiderohet gabim aritmetikor dhe nisur nga kjo del se jemi plotësisht të përgjegjshëm një herit pas përmasimit të Autoriteti Kontraktues duhej të bëj automatikisht kemi çmimin me të ulët në raport me konkurrentet, Pretendimi jonë është aprovuar nga eksperti shqyrtues dhe po ashtu kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim.

Eksperti shqyrtues në raportin e tij ka thënë se ankesa jonë nuk është e njëjte me atë që keni dorëzuar në Autoriteti Kontraktues, OE i propozuar për kontratë ka shumë mangësi të mëdha, në dosje të tenderit dhe nuk ka respektuar detyrën projektuese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Mustafa deklaroj: Ne i kemi kthyer përgjigje me kërkesën për rishqyrtim dhe mënojmë që ka qenë një gabim tek paramasa e tyre, këtë po pretendojnë se nuk është gabim i tyre.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Bushi deklaroj: Qëndroj prapa ekspertizës së dhënë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Morina deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj ankesën tonë plotësisht të bazuar dhe lenden ta kthen në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Mustafa deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhë poshtë ankesën e OE ankuese dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK-ja, ka shkelur nenin 52 pika 1, 3. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE ankues nuk ka paraqitur ndonjë fakte në këtë pike vetëm se ka përshkruar nenin bllanko të marrë nga ligji, andaj konstatohet se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK në kundërshtim me ligjin e ka eliminuar me arsyetimin se OE ankues ka bërë gabim në vlerën e TVSH-së ku vlerën pa TVSH e ka shënuar 440,914.00 €, kurse të vlera me TVSH-së ka vendosur shumën 537,700.00 €. Pra, që i bie se OE e ka vendosur vlerën e TVSH-së mbi 21% e jo 18 % sa është norma e TVSH-së sipas Ligjit në Kosovë. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se, në interpretimin e KRPP-së nr. 46 thuhet se pavarësisht sa është gabimi në normën e TVSH-së, AK mund ta përmirësojë pa njoftuar OE, pasi që nuk llogaritet gabim aritmetik sipas nenit 59.3 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore të paraqitura pranë OSHP-së dallojnë nga pretendimet ankimore të dorëzuara në kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të tërë dokumentacionit, përkatësisht ofertës së dorëzuar nga OE ankues konstatohet që i njëjti nuk e ka interesin materialo-juridik për faktin që i njëjti nuk ka plotësuar kriteret e DT dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës që ndërlidhen me dëshmitë e dokumentuara mbi Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (pikën 9.1 dhe 9.2), Operatori Ekonomik “Abkons SH.P.K; Hidroing-DK SH.P.K; Swedish Development AB” -Tiranë, oferta e konsorciumit të cekur më lartë nuk i plotëson disa nga kërkesat me dosje të tenderit dhe nuk është i përgjegjshëm për shkak të arsyeve si në vijim:

a.Të paktën tre (3) kontrata të realizuara brenda tre (3) viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë dhe secila prej tyre të ngjashme për nga natyra dhe kompleksiteti në Migrimin dhe konvertimit të të dhënave në regjistrat Kadatral, dhe

b.Të paktën dy (2) kontrata të realizuara brenda tre (3) viteve të fundit deri në njoftimin për kontratë dhe secila prej tyre të ngjashme për nga natyra dhe kompleksiteti (minimum 600,000 faqe të skanuara dhe të indeksuara) për nga skanimi dhe indeksimi i dokumenteve.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se AK për aktivitetin e prokurimit në fjalë ka bërë disa shkelje procedurale duke mos vepruar në harmoni me interpretimin e KRPP-së. Mirëpo, duke konsideruar që OE ankues nuk përmbush Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kthimi në rivlerësim vetëm do të prolongonte realizimin e projektit pasi që kemi një OE të papërgjegjshëm dhe që rezultati final do mbetet i njëjti.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK -Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor / MMPH/
- 1x1 OE -“ Abkons SH.P.K; Hidroing-DKSH.P.K; Swedish Development AB ”- Tiranë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim nëweb- faqe të OSHP-së.